



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
PRIZRENU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRIZREN

Nr. 9021 /2010

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRAJTJE NE PRIZREN, me gjyqtarin, Zejnulla Gashi dhe procesmbajtësen, Melihat e Shaipi , në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Sadik Paqarizi nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga lemia e financave , e në bazë të nenit 195 dhe nenit 198 al.1 pika 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt. 04.11.2011, merr,

A K T V E N D I M

PEZULLOHET, procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Sadik Paqarizi nga Prizreni , për shkak të kundërvajtjes nga lemia e financave , sepse data e kryerjes së kundërvajtjes është më 08.06.2010, andaj është shkaktuar parashkrimi relativ për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse në kuptim të nenit 198 al. 1 pika 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet.

- Shpenzimet e procedurës biejnë në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate, në bazë të nenit 110 al. 2 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

A r s y e t i m

Me kërkesën e Axhensise kunder korupcionit , te dt. 22.03.2010, është ngritur procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Sadik Paqarizi nga Prizreni , për shkak të kundërvajtjes nga lemia e financave.

Gjatë shikimit të shkresave, Gjykata sipas detyrës zyrtare, vërtetoi se në rastin konkret, nuk mundë të zhvillohet procedura e mëtejme kundërvajtëse, sepse është shkaktuar parashkrimi relativ andaj, në bazë të 198 al. 1 pika 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit është PEZULLUAR.

Shpenzimet e procedurës biejnë në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate në bazë të nenit 110 al. 2 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRIZREN
Nr. 9021 /2010 të dt.04.11.2011

Procesmbajtësja,
Melihate Shaipi

Gjyqtari,
Zejnulla Gashi

UDHËZIMI JURIDIK; Kundër këtij aktvendimi në afat prej 8 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit, mundë të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë. Ankesa dërgohet nëpërmjet kësaj gjykate pa taksa.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. <u>D.P</u>	Br. Prot. <u>03-4910/11</u>
Dep. _____	Prot No. _____
Nr. lfaq. _____	Data _____
Broj stranica <u>01</u>	Datum <u>20.12.2011</u>
Nr. pages _____	Date _____